

## **Eksporti**

### **Neni 181**

1. Regjimi i eksportit lejon që mallrat shqiptare të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Eksportimi sjell zbatimin e formaliteteve të daljes, duke përfshirë edhe masat e politikës tregtare dhe, kur është rasti, detyrimet e eksportit.
2. Me përjashtim të mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit pasiv, të gjitha mallrat shqiptare të destinuara për eksport vendosen nën regjimin e eksportit.
3. Rastet dhe kushtet në të cilat mallrat që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë nuk i nënshtrohen një deklaratë eksporti, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi dhe, nëse është e nevojshme, me dispozita të nxjerra nga Ministri i Financave.
4. Deklarata e eksportit duhet të depozitohet në zyrën doganore kompetente për mbikqyrjen e vendit ku është vendosur eksportuesi, ose ku mallrat janë paketuar ose ngarkuar për eksport. Në rast se është e

83

nevojshme, përjashtimet nga ky rast përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

### **Neni 182**

Çlirimi i mallrave për eksport jepet me kusht që mallrat në fjalë të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në të njëjtën gjendje që ato ishin në datën e pranimit të deklaratës së eksportit.